

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS, bazuar në nenin 16 të Ligjit nr.03/L-079, për ndryshimin e Rregullores së UNMIK-ut,nr.2006/50, për zgjidhjen e kërkesave lidhur me pronën e paluajtshme private duke përfshirë pronën Bujqësore dhe ate Komerciale, kolegji në përbërje nga gjyqtarët, Ragip Namani kryetar i kolegjit, Beshir Islami dhe Jelena Krivokapic, anëtar me pjesëmarrjen e bashkëpunëtorit profesional Sherif Krasniqi, në çështjen juridike **të palës ankuese;**

S. S.I., Kraljevo, R. Srbija

Kundër

Agjencia Kosovare e Privatizimit

Rruga: Rexhep Mala, Nr. 2

Prishtinë

Përfaqësuar nga;

A. B. (Udhëheqës i Zyrës Rajonale në Prishtinë)

Pala përgjegjëse në ankesë

Duke vendosur lidhur me ankesën e paraqitur, kundër Vendimit të Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KPCC/D/A/260/2014, të datës 21 tetor 2014, (lënda e regjistruar në AKP me numër KPA10433), pas shqyrtimit të mbajtur me datë, 12 Shkurt 2020, merr;

AKTGJYKIM

Hedhet Poshtë si e pas afatshme, Ankesa e paraqitur nga S. S. I., kundër Vendimit të Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës, KPCC/D/A/260/2014, të datës 21 tetor 2014, për sa i përket kërkesës të regjistruar në AKP, me numër KPA10433.

Përmbledhje e çështjeve procedurale dhe faktike

1. Me datë 29 nëntor 2007, S. I. (më tutje: Pala ankuese) ka paraqitur, Kërkesë në Agjencinë Kosovare të Pronës, (më tutje: AKP), në cilësinë e bartësit të pretenduar të drejtës pronësore,(BDP) me të cilën kërkon konfirmimin e të drejtës pronësore dhe ri-posedimin e ngastrës kadastrale nr..., tokë e kultivuar bujqësore, me sipërfaqe prej 01.00.00 ha, e cila ndodhet në vendin e quajtur "...” në fshatin, .../.../, Komuna e Lipjanit, (më tutje: pronat e kërkuara). Në kërkesë thekson se posedimin mbi pronën e kërkuar e ka humbur me 01.01.1999, si pasojë e rrethanave të viteve 1998/99, në Kosovë.
2. Në mbështetje të kërkesës së tij, pala ankuese në AKP, dorëzoi dokumentet në vijim:
 - Aktgjykimin, P.br.114/94, të dt. 21.09.1995, lëshuar nga Gjykata Komunale në Lipjan me të cilin është anuluar kontrata e shitblerjes e vitit 1964, për ngastrën e

kërkuar lëndore në sipërfaqe prej një hektari, dhe është vendosur që nga PIK „Kosmet Export kjo ti kthehet palës kërkuese dhe shtatë bashkëpronareve të tjerë, ndërsa bashkëpronarët obligohen që ta kthejnë çmimin e shitblerjes prej 1.995,00 dinarë .

- Fletëpagesën e vitit 1996, sipas së cilës bashkëpronarët i paguajnë kompensimin Ndërmarrjes Shoqërore në bazë të aktgjykimit të cekur.
 - Përshkrimin e Fletës Poseduese të dt. 08.11.1996, e cila e paraqet palën ankuese si bashkëpronarë me 1/8, pjesë ideale të pronës së kërkuar(ngastrës kad. nr...).
 - Marrëveshjen(Ujdinë) gjyqësore P.726/06, dt.09.10.1997(procësverbal për ndarjen e pronës familjare),sipas së cilës pala ankuese shpallet bashkëpronarë me 1/8,pjesë ideale i pronës së kërkuar dhe të tjerave.
 - Autorizimin e dt. 16.03.2010, sipas së cilit pala ankuese dhe bashkëpronarët e tjerë e autorizojnë avokat I. G. nga ... për ti përfaqësuar lidhur me pronën e kërkuar.
 - Autorizimin nr. 30/2013, të vitit 2013, e vërtetuar tek noter, K. R, Graçanicë me të cilin pala ankuese S. I., e autorizon Z. T. H., nga Prishtina rr. ..., me LNj..., ta përfaqësoj në AKP dhe organe të tjera lidhur me pronën lëndore, sipas kërkesës KPA 10433.
 - Autorizimin, nr. ..., të dt. 27.01.2014, të vërtetuar në Gjykatën Themelore nr. 1 në Beograd, me të cilin M. I. dhe M. I. si dhënës autorizimi, e autorizojnë Avokat Q. Q. nga Prishtina për ti përfaqësuar lidhur me çështje pronësore në të gjitha institucionet në Kosovë dhe gjykata si dhe DHPGJS.
 - Vendimin e Agjencisë Kosovare të Privatizimit, nr. ...,të dt.20.12.2013 sipas së cilit kërkesa e palës ankuese për kompensim të pronës së kërkuar ishte refuzuar si jo valide, në bazë të asaj se ftesa për kreditorët ka skaduar me 16.07.2007,kurse pala ankuese ka paraqitur kërkesën me datë 08.01.2008.
 - Ankesën e tij të vitit 2014, drejtuar dhomës së posaçme të gjykatës supreme ku ai ishte ankuar kundër vendimit të AKP-së për hedhjen poshtë të kërkesës së tij, lidhur me pronën e tij dhe çështje që kanë të bëjnë me Agjencinë Kosovare të Mirëbesimit-tani privatizimit, me të cilën kishte kërkuar rishqyrtimin e lëndës së tij.
 - Vendimin e dt. 07.04.1998, nr. ..., lëshuar nga departamenti i kadastrit me të cilin lejohet regjistrimi i ngastrave të tjera ... dhe ... , në emër të palës ankuese dhe bashkëpronarëve të tjerë me nga 1/8 pjesë ideale, (në këtë vendim nuk përfshihet ngastra kadastrale lëndore, nr...).
3. Njoftimi i Kërkesës KPA10433, fillimisht është bërë me dt. 11.07.2008, prona është gjet tokë e punuar e uzurpuar nga personi i pa njohur. Notifikimi dhe konfirmimi i pronës së kërkuar është bërë me 22 korrik 2010, duke e publikuar kërkesa në Gazetën e Njoftimeve nr.5 të AKP-së dhe në Listën e Zyrës për Prona të UNHCR-së. Gazeta dhe lista janë lanë te prijësi i fshatit i cili pranoi që ta lë atë në dispozicion të palëve të interesuara. Publikimet e njëjta u lanë në hyrje dhe dalje të fshatit Suhadoll, Komunë e Lipjan, në Zyrën Kadastrale Lipjan, në Komunë Graçanicë në Gjykatën Komonale të Lipjan dhe në Zyrën Rajonale të AKP-së në Prishtinë. Gjithashtu, Lista dhe Gazeta u shpërndanë në Zyrën Kryesore të UNHCR-së, te Ombudspersoni, të Agjencia Kadastrale e Kosovës (AKK), te Këshilli Danez për Refugjatë (DRC) dhe te Zyra e UNMIK-ut në Graçanicë.

4. Nga rezultatet e verifikimit, sekretaria e AKP-së, e kontakton Agjencinë Kosovare të Privatizimit, (tutje: Pala përgjegjëse në ankesë), e cila është përgjigjur me shkresë informuese me datë 23.12.2013, përmes A. B. (Udhëheqës i Zyrës Rajonale në Prishtinë), me të cilën theksohet se Agjencia Kosovare e pronave nuk ka juridiksion mbi ngastrën e kërkuar,..., me që kjo pronë është shoqërore e cila ishte administruar nga Ndërmarrja shoqërore Kooperativa Bujqësore, Kosova në Lipjan në periudhën 1996-99, e më pastaj nga AKM-ja, prej vitit 1999 e tutje ,ndërsa prej datës 09.10.2007, kjo ndërmarrje i ishte nënshtruar procedurës së likuidimit nga Agjencia kosovare e privatizimit, ndërsa ndërmarrja shoqërore në emër të cilës evidentohet kjo ngastër kadastrale është në proces të likuidimit, andaj të gjitha procedurat administrative dhe gjyqësore duhet pushuar. Tutje thekson se Agjencia Kosovare e Privatizimit do të bëhet pjesë e procedurës e cila do të zhvillohet pranë AKP-së, në lidhje me ngastrën kontestuese.
5. Në mbështetje të kërkesës, pala përgjegjëse në ankesë Agjencia kosovare e privatizimit i dorëzoi këto prova:
- Letër lajmërimet dërguar gjykatave të vitit 2005, me të cilat Agjencia Kosovare e Mirëbesimit njofton gjykatat dhe në Lipjan të ndalojnë çdo vendim që ka të bëjë me ndërmarrje shoqërore me që një çështje e tillë pronësore në procedurë Gjyqësore është kompetencë e dhomës së posaçme të gjykatës supreme.
 - Njoftimin e vitit 2007,për mes mjeteve të informimit për likuidim të NSH dhe një ftese për të gjithë kreditorët e mundshëm që pretendojnë ndonjë kërkesë të tyre ndaj ndërmarrjes shoqërore.
 - Ri-njoftimin për likuidim drejtuar Dhomës së posaçme të gjykatës supreme, të dt. 28.08.2009.
 - Letër informuese nga departamenti i kadastrit në Graçanicë dt. 29.05.2013, me të cilën kërkohej mendimi i Agjencisë Kosovare të privatizimit dhe leja për zbatimin e aktgjykimit të vitit 1995, për kthimin e ngastrës së kërkuar.
6. Sekretaria e Agjencisë Kosovare të Pronave, në shërbimin kadastral të K. Lipjan, *ex officio*, kishte siguruar Certifikatën e të drejtave pronësore, nr. ..., dt. 20.02.2014, e cila ngastrën e kërkuar kadastrale, nr. ..., e paraqet të regjistruar si pronë shoqërore, në emër Pasuri Shoqërore –Kooperativa Bujqësore Lipjan.
7. Më 21 Tetor 2014, Komisioni për Kërkesa Pronësore të Kosovës me Vendimin e tij KPCC/D/A/260/2014, e hodhi poshtë kërkesën. Në paragrafët 19-20, dhe 30, të Vendimit Grupor, që sipas vendimit të vërtetuar zbatohet veçanërisht për kërkesën në fjalë, ndër të tjera thuhet se, sekretaria e AKP-së, në bazë të dokumenteve dhe dëshmime të ndryshme të siguruara *ex officio*, gjen se prona e kërkuar është shoqërore e vendosur nën administrimin e Agjencisë Kosovare të Mirëbesimit, (dhe më pas nën pasardhësen e saj Agjencia Kosovare e Privatizimit) në bazë të aprovimit sipas Rregullores, UNMIK nr. 2002/12, e ndryshuar me Rregulloren e UNMIK-ut 2005/18. Sipas përfaqësuesit të agjencisë së privatizimit Ndërmarrja Shoqërore është në procesin e likuidimit dhe prandaj prona e kërkuar bie ekskluzivisht nën juridiksionin e Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës sipas nenit 4.1 (c) dhe nenit 5.1 (a) të Rregullores së UNMIK-ut për Dhomën e Posaçme 2008/4.

Në këto rrethana, Komisioni konstaton se bartësi i pretenduar i të drejtës pronësore nuk e ka humbur aftësinë për ta ushtruar të drejtën e tij si rezultat i konfliktit në vitet 1998-1999, por si rezultat i procesit të më vonshëm të privatizimit. Rrjedhimisht, kërkesa bie jashtë juridiksionit të komisionit. Komisioni vëren se vendimi i saj nuk e paragjykon të drejtën e paraqitësit të kërkesës që të kërkojë masa lehtësuese para një gjykate me juridiksion kompetent.

8. Vendimi iu dorëzua palës ankuese S. I., me datë 10 mars 2015. Kundër këtij vendimi i njëjti ka paraqitur ankesë me datë 17 Qershor 2016,(E protok. Me vulë pranimit, "Property office", dhe me datë 23.06.2016,me vulë pranimit të AKP-së).
9. Pala përgjegjëse në ankesë Agjencia Kosovare e Privatizimit, vendimin e KKKPK-së e ka pranuar me 20 shkurt 2015, ankesë ndaj këtij vendimi nuk ka parashtruar.
10. Me datë 28.07.2016, nga Agjencia Kosovare e Pronave, Agjencisë Kosovare të Privatizimit i është dorëzuar kopja e ankesës e palës ankuese për paraqitjen e përgjegjës, në shkresa të lëndës nuk ka prova se ka paraqitur përgjigje në ankesë.

Pretendimet e palës ankuese

11. Pala ankuese, ankesën e adreson në Dhomën e veçantë të gjykatës supreme dhe e titullon: "ankesë në vendimin mbi refuzimin e serishëm të regjistrimit të ngastrës kadastrale nr...", tutje ndër të tjera thekson se; citim, "me vendim i kini tejkaluar të gjitha faktet relevante të cilat janë valide për vendosje pozitivisht të kësaj çështje kontestuese ,sepse sipas Aktgjykimit të gjykatës komunale nr..., i plotfuqishëm prej 04.04.2007, u është kthyer pronësia, ndërsa sipas Fl. poseduese të kadastrit Lipjan, të dt. 08.1.1996, ngastra kad. ..., është e regjistruar në emër të neve bashkëpronarëve, në bazë të vendimit të kadastrit në Lipjan nr. ..., dt.15.07.1998, me të cilin është lejuar bartja e pronësisë nga ish pronari, në neve 8 bashkëpronarëve të saj". Nga këto fakte thekson se dëshkohet që me vendimin refuzues nuk janë marrë për bazë dokumentet e lartë cekura valide, vetëm se jeni shërbyer me afatin e ankesës në këtë kontest jo ekzistues, sepse është në pyetje pasuria, pronar të cilës jemi mbi 20 vite.
12. Tutje pala ankuese thekson se vendimin refuzues për regjistrimin e kësaj prone ja keni dërguar bashkëpronarit I. M., i cili prej marsit është në spital dhe pas lëshimit nga spitali është në gjendje të rëndë psikofizike, se vendimin e juaj e kemi gjetur rastësisht, andaj kërkon që vendimi ti dërgohet të autorizuarit juridik avokat Ç. Ç., i cili gjer më tani ka ndërmarrë veprime juridike lidhur me këtë lëndë duke na përfaqësuar neve, se lajmërimin jeni të obliguar t'ia dërgoni I. S., i cili është i autorizuar prej të gjithë bashkëpronarëve për ti përfaqësuar në të gjitha institucionet në Kosovë, dhe pasi ti keni lajmëruar përfaqësuesit e lartë cekur lidhur me vendimin e juaj, prej asaj dite juridikisht rrjedhin afatet për ankesë.

Arsyetimi ligjor

Pranueshmëria e ankesës

13. Ankesa është e pa pranueshme, sepse është e pas afatshme për sa i përket Vendimit KPCC/D/A/260/2014 , të dt. 21 tetor 2014 .
14. Neni 12.1, i Ligjit nr. 03/L-079, Mbi zgjidhjen e kërkesave lidhur me pronën e paluajtshme private, duke përfshirë pronën bujqësore dhe atë komerciale (në tekstin e mëtejshëm “Ligji nr. 03/L-079”) përcakton si në vijim: *“Brenda tridhjetë (30) ditëve nga njoftimi i palëve nga Agjencia Kosovare e Pronës për vendimin e Komisionit mbi ankesën, pala mund të paraqes ankesë ndaj vendimit të tillë në Gjykatën Supreme përmes Sekretarisë Ekzekutive të Agjencisë Kosovare të Pronës”*.
15. Pala ankuese e ka pranuar personalisht Vendimin e KKPK-së , nr. KKPC/A/260/2014, të dt. 21.10.2014, **me datë 10 Mars 2015**, që konfirmohet me nënshkrimin e tij, dhe nuk është e vërtetë ashtu si e thekson në ankesë se, kinse vendimi i KKPK-së i është dorëzuar I. M., ndërsa ky rastësisht e ka gjetur ndaj të cilit paraqet ankesë. Megjithatë ankesën kundër këtij vendimi pala ankuese e ka paraqitur **me datë 17 Qershor 2016**, (e protokolluar me vulë pranimit në AKP, Property Office, Beograd). Kjo do të thotë se ankesa është paraqitur jashtë afatit të përcaktuar me ligj, 30 ditë, nga dita e pranimit të Vendimit të KKPK-së. Afati për ankesë ka qen gjer me datë 09 Prill 2015.
16. Gjykata ka gjetur se dorëzimi është bërë në përputhje me nenin 110.1, të Ligjit nr. 03/L-006, për Procedurën Kontestimore, (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 38/2008), duke ju dorëzuar personalisht palës ankuese Vendimi i KKPK-së.
17. Pala ankuese në ankesën e paraqitur nuk ka cekur asnjë fakt dhe nuk ka paraqitur asnjë arsye për vonesën në paraqitjen e ankesës, ndërsa as gjykata në shkresat e lëndës nuk ka gjetur asnjë arsye të justifikueshme për vonesën u ushtrimit të kësaj ankese.
18. Edhe pse ankesa është dorëzuar në Agjencinë kosovare të pronave,(zyra pronësore Beograd),sipas theksimeve në ankesë nuk provohet me asnjë fakt se atakohet Vendimi i KKPK-së, i cekur si më lartë, por kontestohet një Vendim, (pa e cek numrin dhe datën e tij), që sipas pretendimeve në ankesë ka të bëjë me mos regjistrimin e pronës kontestuese, ngastrës kadastrale, nr. ..., për të cilën ngastër megjithatë KKPK-ja, me vendimin e ankimuar e ka hedhur poshtë kërkesën e palës ankuese për njohjen e të drejtës pronësore dhe kthimin e posedimit të saj në mungesë të kompetencës lëndore të KKPK-së.
19. Po ashtu në shkresa të lëndës nuk ka prova se lidhur me lëndën KPA 10433, pala ankuese e ka autorizuar ndonjëherë avokat Q. Q., ta përfaqësoj, andaj sa i përket vendimit të ankimuar, KKPC/A/260/2014, të dt. 21.10.2014, vërtetohet se ankesa e palës ankuese është jo e afatshme.
20. Prandaj, ankesa hedhet poshtë si e papranueshme në bazë të arsyeve procedurale të ligjit të lartpërmendur. Rrjedhimisht Gjykata Supreme nuk ka mundur t’i shqyrtoj arsyet e ankesës.
21. Në bazë të asaj që u tha më lart dhe në përputhje me nenin 13.3.(b) të Ligjit nr. 03/L-079 dhe nenin 195, paragrafin 1(a) të Ligjit për Procedurën Kontestimore, është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

22. Me që ankesa i është drejtuar Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme,(DHPGJS), pa e cekur numrin e Vendimit dhe datën e tij të cilin e konteston, kolegji megjithatë një kopje të kësaj ankese të palës ankuese, ia dërgon DHPGJS, që nëse eventualisht kanë në punë lëndë të palës ankuese, sipas pretendimeve të tij në ankesë, e që lidhet me Agjencinë Kosovare të Privatizimit, ta shqyrtojnë dhe vendosin ankesën e palës ankuese në baza ligjore.

Këshillë ligjore;

23. Sipas nenit 13.6 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50, e ndryshuar me Ligjin 03/L-079, ky aktgjykim është i formës së prerë dhe nuk mund të kundërshtohet përmes mjeteve të rregullta apo të jashtëzakonshme juridike.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS NË PRISHTINË
GSK-KPA-A-074-2016, me datë, 12 Shkurt 2020

Bashkp. Profesional
Sherif Krasniqi

Kryetari i kolegjit,
Ragip Namani